



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 91, Datë 06.04.2021

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SH.P.K., PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 35, DATË 04.02.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, nenit 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 8 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 40/2 prot., datë 31.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 04.02.2021, vendosi:
 1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar.
 2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., nr. 64, Seria NPM08P.
 3. Shoqëria “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të bordit nëpërmjet shkresës nr. 51/2 prot., datë 11.02.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.
- Sa më sipër, brenda afatit 30 ditor brenda të cilit shoqërisë i është dhënë e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar në ERE shkresën nr. 06/21 prot., datë 03.03.2021, protokolluar në ERE me nr. 51/4 prot., datë 05.03.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.02.2021.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 35/2021, shoqëria ka paraqitur argumentet dhe dokumentacionin shoqërues.
- Në nenin 8, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për bordin mbi argumentat e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i paraqesin bordit propozimin përkatës.
- Në përmbushje të afatit 30-ditor për të përgatitur relacionin përkatës mbi argumentet e paraqitura nga shoqëria, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 35/2021, me qëllim që t'i jepet mundësia asaj të depozitojë në ERE dokumentacionin vërtetues mbi sa deklaruar nga ana e saj, si dhe për sqarime të mëtejshme apo dokumente shtesë në lidhje me kërkesën e parashtruar.
- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:
 1. *Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.*
 2. *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.02.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “BIOPOWER GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit

AHMETI